



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 36-të (te jashtëzakonshme) të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 13.12.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Shefki Bytyqi, anëtar
3. Gazmend Qerkini, anëtar
4. Shkelzim Olluri, anëtar
5. Albiona Tasholli, anëtare
6. Fadil Sopa, anëtar
7. Sami Bytyqi, anëtar
8. Fitim Shala, anëtar
9. Xhyzide Rustemi, anëtare
10. Rinor Murati, anëtar
11. Armend Grajqevci, anëtar
12. Gentianë Hoxhaj, anëtare
13. Venhar Agushi, anëtar
14. Xhyla Dedushaj, anëtare
15. Lulzim Rustemi, anëtar
16. Ardit Cani, anëtar
17. Arsim Jashari, anëtar
18. Lumturiye Bytyqi-Hasani, anëtare
19. Ganimete Qeriqi, anëtare
20. Alban Salihu, anëtar
21. Fitim Meziu, anëtar
22. Fadil Spahiu, anëtar
23. Fatmir Fetahu, anëtar
24. Shahadije Dragaçina, anëtare
25. Besiana Syla, anëtare
26. Enver Kryeziu, anëtar
- 27.

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i komunës
4. Latif Ramadani, DBF
5. Shkelzen Hajdini, DSHMS
6. Elmaze Behluli, DA
7. Sead Aliu, DI
8. Valon Pacolli, DEZH
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DKA
11. Safete Amerllahu, DGJK
12. Burim Rrustemi, DSHPMSh
13. Imri Semetishti, DUPMM
14. Anila Reqica-Llugiqi, DKRS
15. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se uroj që jeni mirë, pastaj tha se me kërkesë të anëtarëve të kuvendit është thirrë mbledhje e jashtëzakonshme, ku tha se tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Propozim vendim për kundërshtimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësimin e pronave të paluajtshme me qëllim të ndërtimit të “ Deponisë së re Sanitare” për regjion të Prishtinës.

Pastaj Kryesuesi i kuvendit hodhi në votim propozimin dhe pas votimit u konstatua se me 23 vota për, u aprovua rendi i ditës.

I

Propozim vendim për kundërshtimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësimin e pronave të paluajtshme me qëllim të ndërtimit të “ Deponisë së re Sanitare” për regjion të Prishtinës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Armend Grajqevcit në emër të grupit të anëtarëve të LDK-së, i cili në vazhdim i falënderoi të gjithë për përgjigjen pozitive ndaj kësaj thirrje shume të rëndeshe për qytetaret e komunës së Lipjanit, pastaj i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

SHTOJCË: Propozim Vendimi

PROPOZIM V E N D I M PËR KUNDËRSHTIMIN E NDËRTIMIT TË DEPONISË SANITARE

I. Me këtë Vendim, kundërshtohet ndërtimi i “Deponisë së re Sanitare” për regjionin e Prishtinës në zonat kadastrale: Poturoc, Ribar i Madh dhe Qylagë.

II. Kërkohet të bëhet shfuqizimi i pikës tre (3) të paragrafit 1 të Vendimit Nr.33/178 të datës 13.12.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësimin e pronave të paluajtshme me qëllim të ndërtimit të “Deponisë së re Sanitare” për regjionin e Prishtinës.

A r s y e t i m

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën _____2024 kanë diskutuar lidhur me Vendimin Nr.33/178 të datës 13.12.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësimin e pronave të paluajtshme në ZK Poturoc, Ribar i Madh dhe Qylagë, me qëllim të ndërtimit të “Deponisë së re Sanitare” për regjionin e Prishtinës.

Ndërtimi i “Deponisë Sanitare” në zonat e caktuara kadastrale dhe në afërsi të vendbanimeve Ribar i Madh, Poturovc, Qylagë, Vërshec dhe Zllakuqan, do të ketë ndikim të theksuar mjedisor, duke përfshirë edhe ndikimin në shëndetin dhe cilësinë e jetës së banorëve.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, vlerësojnë se kjo hapësirë nuk është e përshtatshme për ndërtim të Deponisë Sanitare dhe për planifikimin e asaj zone nuk janë plotësuar një mori kriteresh sipas rregullatives në fuqi.

Komuna e Lipjanit, po ashtu ka pranuar reagime dhe shqetësime të shumta të banorëve të asaj zone, sidomos të fshatrave Ribar i Madh, Poturovc, Qylagë, Vërshec dhe Zllakuqan lidhur me ndërtimin eventual Depinisë Sanitare.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës vlerësojnë se këto shqetësime janë të bazuara, duke pasur parasysh ndikimin e Deponisë sanitare në shëndetin dhe jeten e tyre.

Duke u bazuar në rrethanat e sipërshënuara, kërkojmë nga Anëtarët e Kuvendit të aprovohet ky propozim Vendim.

Ky Vendim i dërgohet:

Qeverisë së Republikës së Kosovës;

Kryetarit të Komunës; dhe

Arkivit të Komunës.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Imri Semetishtit, i cili tha se Qeveria e Kosovës ka marr vendim me të cilin jeni të njoftuar për shpronësimin e pronave komunale në 3 zona kadastrale në Poturovc, Qylagë dhe Ribar i Madh për ndërtimin e deponisë së re sanitare në sipërfaqe prej mbi 45 hektarë, në kemi kërkuar qartësime për këto studime të fizibilitetit dhe asnjëherë nuk kemi marr përgjigje. Dhe në si drejtoret asnjëherë nuk kemi dhënë pëlqim për këtë zonë. Po ashtu me planin hapësinor të Kosovës një deponi e tillë sanitare në Lipjan nuk është e parapare, prandaj përgjigje e këtij organi është e pa vërtet duke ju referuar planit hapësinor të Kosovës. Kemi pas kërkesë për organizim të debatit publik për këtë deponi, nuk është pranuar kjo kërkesë. Në të vërtetë një deponi të tillë duhet të plotësohen faktorët ligjor dhe ata natyror, dhe këta faktor nuk janë plotësuar dhe përcaktimi për këtë lokacion është i pa bazuar. Në përmes zyrës së avokaturës kemi bërë edhe dy konteste përmes gjykatës rreth këtij lokacioni.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se po flasim për një deponi të re sanitare që lidh fshatrat Poturovc, Qylagë dhe Ribar i Madh dhe disa fshatrat të tjera afër tyre. Kjo zonë është edhe afër rezervatit të kafshëve të egra Blinajë. Që në fillim unë e mbështes kundërshtimin e kësaj deponie për shumë arsye, se pari është zonë e banuar dhe ndërtimi i një deponie sanitare përben rrezik të madh për shëndetin e banorëve, kjo do të ketë ndikim negativ në mjedis në ndotjen e ajrit dhe të ujërave si dhe probleme të tjera që lidhen me higjienën dhe problemet e jetës të qytetarëve të regjionit të asaj ane. Aq më tepër aty ndodhet edhe zona ekonomike e Kërçevës që ka një impakt të zhvillimit ekonomik. Se dyti nuk i përmbush kriteret ligjore. Lokacioni nuk u përmbush standardet, se treti nuk janë dëgjuar fare zërat e qytetarëve të cilin e kundërshtojnë këtë deponi dhe janë të shqetësuar për këtë. Dhe në fund kërkoj nga ana juaj anëtar të kuvendit që të mbështetni këtë propozim vendim për ta shfuqizuar vendimin. Nëse nuk na bini projekte ju lutem mos na bini as këtë deponi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albiona Tasholli, tha se sot, në kemi ardhur këtu për të ngritur zërin kundër një padrejtësie të vazhdueshme që po u bëhet qytetarëve të Komunës së Lipjanit nga qeveria aktuale. Është momenti që të mos heshtim më, sepse heshtja nënkupton pranimin e një trajtimi të padenjë dhe diskriminues nga ata që duhet të jenë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës. Kryeministri Albin Kurti dhe qeveria e tij, në vend që të veprojnë si udhëheqës të të gjithë Kosovës, vazhdimisht po e neglizhojnë dhe dëmtojnë Komunën e Lipjanit. Përveçse nuk kemi parë asnjë projekt zhvillimor të rëndësishëm për komunën tonë, në kemi mbetur jashtë planeve buxhetore, jashtë investimeve dhe jashtë vëmendjes së nevojshme për një zhvillim të barabartë, por kjo

qeveri ka zgjedhur që ta trajtoj Lipjanin si një komunë të dorës së dytë. Kjo qasje është jo vetëm e padrejtë, por edhe e papranueshme. Tani, kjo qeveri ka shkuar edhe më larg, sepse ka marr vendimin përfundimtar për shpronësimin e pronave të paluajtshme në Zonat Kadastrale Poturoc, Ribar i Madh dhe Qylagë me qëllim të ndërtimit të Deponisë së Re Sanitare për Regionin e Prishtinës, vendim që jo vetëm që është i njëanshëm, është marrë pa u këshilluar me askënd. Nuk është pyetur Komuna, nuk është pyetur Kuvendi Komunal dhe as qytetarët që preken drejtpërdrejt. E gjithë kjo nuk mund të shihet ndryshe përveçse një hakmarrje politike ndaj qytetarëve tanë, për faktin se kjo komunë ka zgjedhur një drejtim të ndryshëm politik nga ai i partisë në pushtet. Por, qeveria duhet të ketë parasysh se: qytetarët e Lipjanit nuk janë lodra politike që mund t'i përdorni për të realizuar agjendat e tyre! Nëse qeverisja juaj ka vendosur të ndëshkojë një komunë të tërë për shkak të bindjeve politike, atëherë kjo është shkelja më e rëndë e parimeve demokratike. Ky është një akt i pastër diskriminimi, një dëshmi e arrogancës dhe mungesës së respektit për qytetarët e Lipjanit, të cilët janë njësoj pjesë e kësaj republike si gjithë të tjerët. Lipjani nuk ka nevojë për fjalë të mëdha; ajo ka nevojë për vepra konkrete. Ne nuk do të heshtim. Nuk do të lejojmë që të trajtohem si qytetarë të dorës së dytë. Nuk do të pranojmë që të sakrifkohet shëndeti dhe mirëqenia e fshatrave tona për hir të një vendimi të njëanshëm dhe të padrejtë. Le t'i tregojmë kësaj qeverie se Lipjani nuk do të nënshtrohet dhe nuk do të heshtë përballë padrejtësisë.

Arsim Jashari, tha se PDK ka reagur nga fillimi kundër kësaj deponia en kemi reaguar para 2 viteve për këtë çështje ndërsa sot pas 1 viti po flitet ne kuvend për te. Ju keni qëndruar ne heshtje për 1 vit dhe tani ndërkohë është dashtë te ndermirën masa parandaluese nga ana juaj. Tani pa pritur na ftoni për një seance te jashtëzakonshme. Grupi iniciues është dashtë me ta ftuar edhe neve për nënshkrimin e këtij. Ne grupi parlamentar i PDK-se, i kemi përkrah çdo here ata qe është ne te mirën e qytetarëve, sepse ne jemi për interesin e qytetarëve jo për interesin e individëve. Ne grupi i PDK-se, jemi mbledhur për ta kundërshtuar një vendim i cili për neve është i pa pranueshëm. Por kemi një pyetjeje se cilat parcela përfshin në këtë shpronësim, a jen prona private te komunës apo shtetërore. PDK-ja, e kundërshton fuqishëm vendimin e qeverise dhe mbështesim fuqishëm vendimit dhe qëndrojmë afër interesave te qytetarëve, sepse mbrojtja e mjedisit, shëndeti publik dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik duhet te jete prioritet i çdo vendimi nga institucionet tona.

Alban Salihu, tha se kjo seance vetëm formalisht është thirre nga anëtarët e kuvendit të LDK-së, iniciatori i vërtet i saj është kryetari i komunës Imri Ahmeti e gjithë kjo për ti shërbyer LDK-se, në zgjedhje nacionale. Kryetari i komunës nuk e ka

hallin e qytetareve te komunës se Lipjanit halli i tij janë zgjedhjet nacionale e 9 shkurtit dhe sulmet ndaj qeverise se Kosovës. Mënyra e thirrjes koha e thirrjes ka te beje me fushatë parazgjedhorë. Unë i kam disa foto te bere ne vitin 2016 ne oborrin e çerdhes se qytetit, po ashtu edhe ne vitin 2024 është bere ne te nijetin vend me mbeturina. Dhe ky nuk ka qene në gjendje për 8 vite një hapësirë aq te vogël te pastroj madje ne një ambient mjaft te ndishem. Kjo deponi mbeturinash ndodhet ne fshatin Topliqan kjo tjetra ne fshatin Qylage, kjo eshët qeverisja e Imri Ahmteit. Ne kemi marr informata rreth këtij projekti investim nga Banka Zhvillimore dhe Bashkimi Evropian përmes një garanti për përmirësimin dhe trajtimin e mbeturinave ne vendin tonë. Ky projekt ka te beje me 7 komuna duke e përfshirë edhe Lipjanin. Natyrisht lokacioni ne Lipjan nuk është një vendim politik, por një zgjedhje teknike e bazuar në analiza te detajuara te eksperteve te bankës Zhvillimore Gjermane qe kane siguruar e ai i përmbush te gjitha standarde. Ne nuk do te bëhemi pjesë e kësaj fushate dhe nuk do te marrim pjese ne këtë mbledhje si grup i VV-së.

Egzona Bytyqi, tha se sot ne këtë mbledhje te jashtëzakonshme po diskutojmë dhe kundërshtojmë ashpër një vendim te qeverise se Kosovës lidhur me shpronësimin e tokave te paluajtshme për ndërtimin e deponise se re sanitare ne parcelat kadasrale përfshirë fshatin Qylagë Ribar i Madh dhe fshatrave afër tyre i cili shpronësim për mua është një lloj çmenduria ne veti. Këtë e them në baze te disa fakteve dhe argumenteve te cilat do ti listoj sot. Nuk është hera e para qe e kam kundërshtuar këtë deponi ,e dyta me kane penguar shume këto veprime tinëzarë te qeverisë ne raport me komunën tonë, te cilat janë vendime te pa menduar mire dhe me pasoja afatgjate. Ky vendim nuk është parapare në hartën zonale të komunës tonë dhe as një dokument tjetër, dhe as ne planin hapësinorë te republikës se Kosovës dhe tash te na vjen ne këtë forme është e pa pranueshme. Kjo deponi ka me ndikuar ne cilësinë e tokës ujit dhe ajrit. Ndikim negativ do te ke edhe ne aspektin ekonomik. Kjo deponi, përveç qe akne veti kacergjene her pas here mundem me ndodh edhe shpërthime. Çështja tjetër afërsia e parkut nacional te Blinajes. Për fund para vendime te tilla duhet te jemi shume koshient dhe ti thirremi unitetit.

Gentianë Hoxhaj, tha se dua te shpreh mbështetjen time për kolegun tim i cili ka ngrit për kundërshtimin e lokacionit për deponine e mbeturinave, ku kjo prek shëndetin mirëqenien dhe mjedisin e komunitetit tonë. Kolegu ngriti shqetësimet duke i argumentuar, ne jemi për ti përfaqësuar interesat e qytetarëve dhe vendimet tona jen duke i menduar mire afatgjate dhe ne harmoni me standardet me te larta. Ju ftoj qe ti merrni parasysh këto me seriozitetin me përgjegjësinë me te larte.

Rinor Murati, tha se sot jemi mbledhur këtu për ta kundërshtuar vendimin e qeverise për shpronësimin e pronave të paluajtshme me qellim te ndërtimit te deponise së re sanitare për regjionin e Prishtinës. Vendim i pa analizuar mirë pa e diskutuar, një vendim anashkalimi dhe nënçmimi për te gjithë qytetarët e Lipjanit veçanërisht për banoret e fshatrave Poturovc,Ribar i Madh, Vershevc Qylagë dhe Zllaguqan. Edhe ne këtë kuvend kam adresuar për te disa here çështjen e mbeturinave. Por edhe shume here nga kolegen është ngritur kjo çështje. Ndërsa sot komunës tone donë te ja veshin edhe një deponi regjionale, mbeturinat e Prishtinës, Podujevës, Obiliqit, Fushe Kosovës, Graçanicës Drenasit. Kjo deponi është një fatkeqësi për qytetaret tonë.

Lumturije Bytyqi- Hasani, tha se natyrisht mbetem prapa çdo fjale te thënë shefi i grupit të PDK-së dhe dr Egzona, por kam disa çështje te ia drejtor incuesit te kësaj kërkesë apo propozim vendimit Armendit . Kërkesa se pari është e pa plote sepse është dashtë qe te i bashkëngjittë dhe vendimi i qeverise, unë e kam gjet ne faqen e qeverisë. Ka qen një lëshim nga ana juaj. E dyta, ndoshta me shume teknike, kuvendi mban mbledhje te rregullta, te jashtëzakonshme dhe urgjente por jo takime qe janë te përcaktuara me ligj. Pse keni prit 1 vit qe me thirre seance te jashtëzakonshme edhe pse ekzekutivi nuk kish nejt duarkryq. Tjetra sa ka me pas efekt juridik ky vendim qe me ndal vendimin e qeverisë.

Lulzim Rustemi, tha se jemi para një teme shumë te rëndësishme për shëndetin e qytetarëve te komunës së Lipjanit, thirrja e mbledhjes se jashtëzakonshme më se pakti i takon te thirret e jashtëzakonshme, jo për shkak te rëndësisë dhe peshës qe ka, por për shkak të kohës. Një vit ka kaluar nga viti 2023 ne 2024 dhe kjo është e pa falshëm. Unë këtë temë e kam ngrite ne dhjetor te vitin 2022 ne këtë kuvend i kam shtuar pyetje e jeni ne dije qe po flitet për një deponi regjionale ne komunën e Lipjanit dhe nuk është ndërmarr asnjë veprim dhe asnjë masë nga ana juaj dhe kjo është e pa falëshme. Tash pas dy viteve ne debatojmë ne kuvend dhe kjo o shumë e vonë. Ju asmbelistet e LDK-së, nuk keni reaguar. Është dashtë me pas peticionet e fshatrave qe preket drejtpërdrejt. Është dashtë me dal me një plan këtu ne kuvend me na tregu se çfarë demi na behet cilat zona janë a janë prona private a publike. Këtu duhet te këtë kundërshtime të argumentuara. këtu eshët vendi me i pa përshtatshëm më i pa papranueshëm, pasi qe eshët zona ekonomike, parku nacional. Nuk e kemi në material as vendimin e qeverisë dhe kjo është jo serioze nga ana juaj. Ne si grup qëndrojmë fuqishëm ne kundërshtim të kësaj deponie dhe në marrje te masave te reja ne kundërshtim te kësaj deponie sepse kjo eshët e pa pranueshme për komunën e Lipjanit dhe qytetaret e saj sepse rrezikohet shëndeti dhe ambienti.

Armend Grajqevci, tha se u potencua nga parafolësi se nuk kemi diskutuar për këtë çështje kurrë, se unë i them e kam ngrit disa here këtë çështje ne kuvend komunal dhe kam kërkuar nga drejtori i urbanizmit një sqarim, i cili na ka treguar për gjendjen e asaj zone ne atë kohë. Unë kam pyetje nëse keni ngrite këtë teme ne vitin 2022 pse nuk keni bere kërkesë për thirrje te seancës se jashtëzakonshme. Unë ju falënderova te gjithëve qe keni marr pjese ne mbështetje te kësaj iniciative.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se disa çështje i shpjegoj drejtori kronologjikisht, ne ligjërisht dhe zyrtarisht kemi vepruar brenda afateve ligjore ne secilin veprim juridik qe ka marr qeveria dhe ne te njëjtën kohe kemi vepruar mbi bazën e përgjegjësiwe ligjore qe ka. Pse është vonuar legjislativi nuk është faji i ekzekutivit deh askujt nuk ju ka mohuar e drejta me e provuar. Ata qe dojne me mbështet kërkesën për kundërshtimin e deponise sanitare munden. Shumë thelbësorë është me e kundërshtua këtë pak është me rendësi kush e merr bajrakun. Por e keqja eshët se qytetaret e Lipjanit po përballen më te. Unë sa te jem kryetar nuk do te pranoj kurrë qe me u bërë ajo deponi. A do te kemi mundësi më ndal ajo është diçka tjetër. Atje po ndërtohet një zone e biznesit dhe atje me u bere një deponi është jo ne rregull dhe kjo pasqyron e çfarë vizioni ka qeveria jonë. Unë kam biseduar me ministrat Liburn Aliu dhe Rozata Hjadarin. Liburn Aliut, i kam thënë se ajani tu e dite ku jeni tu dashtë më bo ata deponi a jeni dal me pa. Pasi qe me këtë deponi do te preket i gjithë Lipjani sepse ata kamionë te cilët i bartin mbeturinat nga Podujeva e Prishtina ne Lipjan do te kalojnë edhe neper Lipjan edhe në fshatrat rrethit dhe impakti eshët me i madh se kaq. Ne nuk jemi kundër zhvillimit te shtetit tone, por kjo nuk ndodh për inate politike dhe kam frike qe kjo po ndodh për këtë pune, ka studim fizibiliteti por nuk ka tik për këtë vend, sepse janë 6 vende, mirëpo më qëllim politik është caktuar ky vend. Unë do ta shfrytëzoj çdo përgjegjësi ndaj një vendimmarrje te tillë. Neve na takon te gjithëve pa dallim te reagojmë për këtë teme dhe duhet te jemi unik si kuvend dhe si legjislativ.

Fadil Spahiu, tha se shumica e çështjeve u thane nga parafolësit, por e kam një pyetje për drejtorin se a keni marr vendim paraprak preliminar, sepse vetëm atë vendim kemi mujt ta kundërshtojmë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se e kam një pyetje ju thatë qe kjo pune është bere me shume politike, e ka qu edhe ne Podujeve dhe në Gjilan ku qeverise VV-ja. Dhe e dyta sa ka pas ndikim kompania rajonale Prishtina

Ganimete Qerqi, tha se kam një pyetje, ne në Sllatine e kemi fabrikën e prodhimit të barnave, ndërsa ne anën tjetër po donë me u bere deponia për prishjen e barnave, a din se sa demi do te na bëhet.

Armend Grajqevci, tha se edhe unë e kam vendimin qeveritar te Qeverisë, dhe në zonat tjera nuk është ndërtim, por është ose zgjerim ose renovim, ndërsa ndërtim është vetëm Lipjani.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se natyrisht qe ndaj vendimit preliminar është bere kundërshtimi jonë ne gjykatë por nuk ka akoma ndonjë vendimmarrje nga gjykata. Por kjo nuk e stopon procedurën. Ne jemi ne rregull me procedurën. Është stopuar njëherë për shkak te zgjedhjeve, por si te përfundojnë zgjedhjet më pas mundësi do ta beje. Janë 4 deponi, por ato janë ekzistuese pasi qe shënon rikonstruim vetëm deponia e Lipjanit është e re te tjerat janë ekzistuese. Ndërsa kompania nuk merret me deponi, është një organizatë tjetër për deponite qe menaxhohet prej qeverise.

Imri Semetishti, tha se vetëm disa informata për pronat e pronësuara, behet fjale për prona publike, shërbimi pronësor se bashku me gjeodezi kadastër dhe urbanizëm kane reaguar duke thënë se te gjitha këto prona janë ne pronësi te komunës për çka qeveria nuk i ka trajtuar si te tilla, 3 i ka shpronësuar qeveria ndërsa një nuk e ka shpronësuar se e ka trajtuar si rruge. Janë shpronësuar gjithsej 12 parcela. Ne kemi iniciuar procedure kontestimore. I kemi dy konteste ne gjykatë.

Arsim Jashari, tha qëllimi është qe ne si kuvend ta kemi një vendim dhe mos ta neglizhojmë këtë çështje dhe te vazhdojmë me proceduar, po ashtu nëse eshët nevoja te vazhdojmë edhe me peticione e protesta. Kam një pyetje shpronësimet qe ju ka bere ministria a ju ka deponuar mjetet komunës.

Imri Semetishti, tha se 3 pronat e vlerësuara mbi 2 hektar, kompensimi mbi 68 mije uro. Komuna nuk ju ka përgjigj ftesës për dërgim te mjeteve dhe jemi ne kontest gjyqësor.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ju falënderoj të gjithëve qe jeni pjese e kësaj mbledhje, qe është interes për te mire e te gjithë qytetarëve. Nuk po me vjen mire qe grupi i VV-së, pas diskutimit qe bënë e lëshoj mbledhjen. Qytetaret e komunës tonë është mire me e pa sepse njerëzit te cilët janë ne pushtet e te cilët duhet bashkërisht me qen këtu dhe me diskutua qe kjo deponi mos te vjen ne Lipjan. Ndërsa ata e lëshojnë sallën dhe e marrin barrën për vete. Nuk është vone mbledhja sepse bashkërisht duhet te jemi për të mirën e qytetarëve.

Imri Semetishti, tha se kam një propozim qe te titulli ne vendim për kundërshtimit te jetë vendim për anulimin e vendimit te qeverisë, për ndërtimin e deponisë sanitare.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha ne nuk mundemi me anuluar atë vendim pasi qe ne nuk kemi kompetence me anuluar. Na jena tu marr vendim qe me i kërkuar qeverisë me anuluar, sepse ene nuk mundemi me anuluar.

Pastaj Kryesuesi e dha një pauze prej 5 minutave për konsultim rreth titullit te vendimit ne mes te, drejtorit, juristeve dhe anëtareve te kuvendit.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se kthehemi ne mbledhje pas konsultimeve me te zyrës ligjore, ne mes te grupeve dhe anëtareve të kuvendit, titulli do te mbetet i njejt, me këtë vendim kërkohet anulimi i ndërtimit te deponisë së re sanitare për regjionin e Prishtinës.

Dhe pika 2 mbetet ashtu siç ka qenë.

Me qe diskutime të tjera nuk pati, Kryesuesi i kuvendit hodhi në votim propozimin me propozimet e cekura me larte dhe pas votimit u konstatua se me 23 vota për, u aprovua rendi i ditës.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:20.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi